



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Organi Shqyrtues i Prokurimit
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body



Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 262/23

Data: 07.07.2023

Organi Shqyrtues i Prokurimit - Paneli Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Wood Corporation" Sh.P.K. të datës 08.05.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Furnizimi me inventar për QPS-Prishtinë" me numër të prokurimit 616-23-1336-1-2-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 07.07.2023 merr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e operatorit ekonomik "Wood Corporation" Sh.P.K. me nr. 262/23 e datës 08.05.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Furnizimi me inventar për QPS-Prishtinë" me numër të prokurimit 616-23-1336-1-2-1.
- II. VËRTETOHET** Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
- III. URDHËROHET** konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 24.02.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me inventar për QPS-Prishtinë" me numër të prokurimit 616-23-1336-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 20,000.00 €.

Me datë 14.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpallur fitues operatorin ekonomik "Mobelland" Sh.P.K.

Me datë 19.04.2023 operatori ekonomik ankues "Wood Corporation" Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 28.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Duke qenë i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 28.04.2023, operatori ekonomik ankues me datë 08.05.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 262/23.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I)** - *“Garancioni i tenderit/polica e sigurimit është për është lëshuar nga data 20.03.2023 (aktive për 90 ditë) ndërsa data e dorëzimit të tenderit ishte 21.03.2023 dhe nga kjo datë kërkohej që garancioni i tenderit të vlej për 90 ditë, që do të thotë se garancioni i operatorit ishte aktiv për 89 ditë apo 1 ditë më pak sesa kërkesa e dosjes së tenderit”.*
- **Pretendimi i dytë (II)** - *“Aneksi 6 është modifikuar dhe i njëjti nuk është sipas kërkesave të dosjes së tenderit pasi që mungojnë të paktën tre kategori të informatave”.*
- **Pretendimi i tretë (III)** - *“Çmimi i ofruar me TVSH dhe pa TVSH në FDT nuk përputhen, që do të thotë se operatori ka një gabim aritmetik dhe këtë përmirësim nuk e ka bërë Autoriteti Kontraktues sipas obligimit”.*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 57, dhe 72 të LPP si dhe nenin 38 dhe 40 të RRPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 18.05.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si vijon:

- *“Sipas rregullave dhe parimeve të LPP-së konkretisht duke pas për bazë nenin 7ë Ligjit për Prokurim Publik si dhe rregullat tjera sekondare lidhur me prokurimin publik OE pjesëmarrës një aktivitet të prokurimit duhet trajtuar dhe vlerësuar në përputhje me këtë dispozitë, andaj në cilësi të ekspertit shqyrtues konsideroj se AK duhet të rivlerësojë aktivitetin e prokurimit sepse çështja e lidhur me validitetin për sigurim të ofertave është e trajtuar qartë me dispozitat e LPP-së e të cilat duhet të përmbahet AK-ja . Sipas kërkesës në dosjen por edhe rregullave të prokurimit publik validiteti i sigurimi të ofertës duhet të jetë 90 ditë nga data hapja e ofertave dhe sipas analizave rezulton se OE i rekomanduar ofron validitet të sigurim të ofertës për 90 ditë nga data 20.03.2023 e jo validitet për sigurim të ofertës nga data e hapjes e ofertave e që ka qenë data 21.03.2023”.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ankues nuk kanë shfrytëzuar të drejtën për të paraqitur mendimin e tij lidhur me raportin e ekspertit. Ndërsa Operatori ekonomik ka dorëzuar te Paneli Shqyrtues njoftimin sipas të cilit Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit me arsyetimin si në vijim: *“Pajtohemi vetëm pjesërisht sa i përket konstatimit për validitetin e sigurimit të ofertës në lidhje me pretendimet e tjera ankimore mendojmë se eksperti ka dhënë konstatime të gabuara për arsyet si në vijim: 1. TVSH llogaritet mbi çmimin bazë të cilit i shtohet vlera 18 përqind dhe nuk mundet që oferta të llogaritet vetëm në total, por e njëjta llogaritet me çmim bazë të ofertës, diçka e tillë është e rregulluar edhe me Direktivën e BE-së për Prokurim Publik e cila kalkulimin e çmimit e bënë pa TVSH dhe pastaj norma e TVSH-së shtohet si e tillë. 2. Modifikimi i dokumenteve apo anekseve të autoritetit kontraktues është i palejueshëm pasi që në këtë formë vet operatorët do të ofrojnë të dhënat që dëshirojnë dhe si e tillë kjo do të ishte ndërhyrje në dokumentet standarde të publikuara nga autoriteti kontraktues. Një precedent i tillë do të lejonte kaos në prokurim publik. Procedura e prokurimit është strikte formale dhe nëse si operator duhet të respektojmë të gjitha kërkesat e autoriteteve kontraktuese, andaj modifikimi i aneksave nuk lejohet”.*

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës ka konstatuar se *“Sipas kërkesave të dosjes por edhe rregullave të prokurimit publik validiteti i sigurimi të ofertës duhet të jetë 90 ditë nga dita e hapjes së ofertave dhe sipas analizave rezulton se OE i rekomanduar ofron validitet për sigurim të ofertës për 90 ditë dhe validiteti i sigurimit të ofertës fillon nga data 20.03.2023 e jo nga data e hapjes së ofertave e që ka qenë data 21.03.2023”*. Operatori ekonomik ankues është pajtuar pjesërisht me këtë konstatim të ekspertit shqyrtues mirëpo nuk ka ofruar sqarime pse nuk është pajtuar plotësisht respektivisht nuk ka ofruar sqarime se me cilën pjesë të këtij konstatimi nuk pajtohet. Përndryshe Paneli Shqyrtues ka gjetur se nuk është fare kontestues fakti në dosjen e tenderit është kërkuar “sigurimi i tenderit për 90 ditë nga hapja e tenderëve”. Po ashtu nuk është kontestues fakti që hapja e tenderëve është bërë me datë 21.03.2023. Këto dy fakte nuk janë kontestuese pasi që evidentohen si të tilla në ankesën e operatorit ekonomik ankues por edhe në vendimin e datës 28.04.2023 të autoritetit kontraktues mbi kërkesën për rishqyrtim. Për më tepër këto fakte jokontestuese mund të konfirmohen edhe përmes dosjes së tenderit respektivisht përmes procesverbalit të hapjes së tenderëve.

Duke u nisur nga faktet jokontestuese si më sipër është arritur përfundimi se kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë ofrimi i sigurimit të tenderit për 90 nga data e hapjes së tenderëve që nënkupton nga data 21.03.2023 deri me datën 18.06.2023. Me fjalë të tjera sipas dosjes së tenderit është kërkuar që tenderuesit të ofrojnë policën e sigurimit të vlefshme për periudhën 90 ditore nga data 21.03.2023 (duke përfshirë edhe këtë datë) deri me 18.06.2023 (duke përfshirë edhe këtë datë).

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues është se operatori ekonomik fitues ka ofruar sigurimin e tenderit vetëm për 89 ditë dhe atë nga data 20.03.2023 deri me datë 18.06.2023. Këtë fakt Paneli Shqyrtues e ka konfirmuar edhe nga dosja e ofertës së operatorit ekonomik fitues ku ndër të tjera është gjetur se deklarata e garantuesit - siguria e tenderit si pjesë përbërëse e polices me nr. 111424 përcakton se *“kjo siguri vlen nga data 20.03.2023 deri me datë 18.06.2023”*. Rrjedhimisht nuk është kontestues as fakti që operatori ekonomik fitues ka ofruar sigurinë e tenderit nga data 20.03.2023 deri me datën 18.06.2023. Mirëpo ky fakt nënkupton që periudha kohore 90 ditore që është kërkuar të mbulohet sipas dosjes së tenderit nga data 21.03.2023 deri me datë 18.06.2023 është mbuluar tërësisht nga operatori ekonomik fitues. Paneli shqyrtues potencon që nga data 20.03.2023 deri me datë 18.06.2023 janë 91 ditë kalendarike dhe jo 89 sikurse pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Rrjedhimisht është gjetur se operatori ekonomik fitues jo vetëm që ka mbuluar periudhën përkatëse 90 ditore me sigurinë e tenderit, por në fakt e ka tejkaluar këtë periudhë. Kuptohet se tejkalimi i periudhës kohore që kërkohet nga sigurimi i tenderit nuk përbën asnjë shkelje ligjore në rastin konkret. Përndryshe edhe vet operatori ekonomik ankues e ka tejkaluar këtë periudhë kohore pasi që ka ofruar sigurinë e tenderit po ashtu për 91 dhe atë nga data 21.03.2023 deri me datë 19.06.2023 (polica e sigurimit nr. 111466). Sidoqoftë autoriteti kontraktues me të drejtë ka gjetur se në rastin konkret operatori ekonomik fitues e ka përmbushur në tërësi kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me sigurimin e tenderit. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë (II) i Operatorit Ekonomik Ankues është pretendim i bazuar në tërësi.**

Duhet cekur se Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin raportit të ekspertit lidhur me këtë pretendim ankimor pasi që eksperti shqyrtues në këtë rast i referohet dispozitave për validitetin e tenderit konkretisht nenit 30 të RRPP. Në anën tjetër pretendimi i operatorit ekonomik ankues ka qenë i ndërlidhur me sigurimin e tenderit që rregullohet me nenin 28 të RRPP. Me fjalë të tjera konstatimi i ekspertit shqyrtues nuk i referohet fare pretendimit ankimor të operatorit ekonomik ankues. Për më tepër eksperti shqyrtues në rekomandimin e ofruar potencon se *“AK duhet të rivlerësoj aktivitetin e prokurimit sepse çështja e lidhur me validitetin për sigurim të ofertave është e trajtuar qartë me dispozitat e LPP-së e të cilat duhet ti përmbahet AK-ja”*. Megjithatë eksperti nuk tregon se cilave dispozita ligjore në fuqi i referohet konkretisht në këtë rast dhe për më tepër, nuk sqaron fare pse autoriteti kontraktues në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore. Në këtë kuptim Paneli Shqyrtues ka gjetur se ky konstatim i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë ankimor nuk është i plotë dhe nuk është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës ka konstatuar se *“Pretendimi nr. 2 që lidhet me çështjen e referencave është i paqëndrueshëm pasi që OE i rekomanduar ka ofruar dëshmi se ka referenca të realizuara në vlerë mbi 1 milion Euro ndërsa vlera e kërkuar është 20.000 Euro dhe ka pak rendësi se OE i rekomanduar ka përdor shablloni e AK-së apo aneksin 6 të dosjes pasi që në një formë apo tjetër OE ka dëshmuar se i plotëson kapacitetet e kërkuara në dosje dhe në rastet kur ka paqartësi AK mund të kërkojë sqarime apo informacione shtesë nga OE-të por jo plotësim të kërkesave dhe në rastin konkret nuk ka mos respektim të rregullave dhe dispozitave të LPP ashtu siç pretendohet në ankesë”*.

Duhet theksuar se operatori ekonomik ankues as në ankesë dhe as në përgjigjen ndaj mendimit të ekspertit nuk e konteston askund faktin se operatori ekonomik fitues ka ofruar të dhëna të mjaftueshme për të përmbushur kriterin e dosjes së tenderit. Pretendimi i ankuesit më tepër i referohet mënyrës si është plotësuar aneksi 6 i dosjes së tenderit konkretisht mos-plotësimi të disa kategorive të dhënave. Me këtë rast duhet cekur se sipas dosjes së tenderit (kapacitetit teknik dhe profesional) është kërkuar lista e plotësuar aneksi 6 i Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar *“titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve”*. Tutje me raportin e komisionit vlerësues por edhe me vendimin e datës 28.04.2023 mbi kërkesën për rishqyrtim të ankuesit është evidentuar se ky kriter është plotësuar në mënyrë të rregullt nga tenderuesi i rekomanduar pasi që janë ofruar të gjitha të dhënat e kërkuara me dosjen e tenderit. Në këtë drejtim Paneli Shqyrtues e konfirmon edhe konstatimin e ekspertit shqyrtues që në rastet kur Autoriteti Kontraktues mund të ketë dilema apo paqartësi eventuale, bazuar në nenin 38 të RRPP mund të kërkojë informata apo sqarime shtesë nga operatorët ekonomik. Përndryshe argumentimi i ekspertit shqyrtues është në tërësi i bazuar në LPP dhe RRPP por edhe në dokumentet që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me këtë pretendim i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë (II) i Operatorit Ekonomik Ankues është pretendim i bazuar në tërësi.**

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor, eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës ka konstatuar se pretendimi i operatorit ekonomik ankues se ka ofertuar me çmim 0.42 Euro më të ulët se operatori ekonomik i rekomanduar *“nuk është pretendim i qëndrueshëm për faktin se OE i rekomanduar dhe OE ankues ofrojnë çmim të njëjtë si te formulari i tenderit njëkohësisht edhe te përshkrimi i çmimeve dhe çmimi total tek të dy OE është në vlerë të përgjithshme prej 10,590.00 Euro që nënkupton se brenda çmimit të përgjithshëm është përfshirë edhe vlera e TVSH por sipas procesverbalit të hapjes së ofertave OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim pa TVSH në vlerë 8,975.00 Euro ndërsa OE ankues me çmim 8,974.50 Euro, por në total të dy Operatorët Ekonomik (ankues dhe i rekomanduar) ofrojnë çmim të përgjithshëm prej 10,590.00 Euro. Kur çmimi i përgjithshëm (totali) është i njëjtë atëherë pak ka rëndësi kjo diferencë sepse përqindja e TVSH-së që aplikohet është e njëjtë si për OE ankues njëkohësisht edhe nga OE të rekomanduar për kontratë dhe ne raste kur kemi dallime të tilla sipas rregullave të LPP-së lejohet të korrigjohet dhe nuk konsiderohet asnjë lloj devijimi apo gabimi i cili mund të përdoret si arsyetim për eliminim”*.

Duhet theksuar se operatori ekonomik ankues as në ankesë dhe as në përgjigjen ndaj mendimit të ekspertit nuk e konteston askund faktin se çmimi i përgjithshëm (përfundimtar) me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është në shumën 10,590.00 Euro (me të njëjtin çmim ka ofertuar edhe vet operatori ekonomik ankues). Pretendimi ankimor i referohet vetëm faktit që kalkulimi deri te çmimi përfundimtar nga tenderuesi i rekomanduar sipas ankuesit përmban një gabim aritmetik. Në anën tjetër Autoriteti Kontraktues në raportin e vlerësimit por edhe në vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim, ka marrë si të mirëqenë çmimin përfundimtar me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Duke u referuar te kjo gjendje faktike, Paneli Shqyrtues fillimisht potencon se me rastin e nënshkrimit të një kontrate të prokurimit, detyrimet financiare të Autoritetit Kontraktues i referohen çmimit përfundimtar me të cilin ka ofertuar operatori ekonomik fitues (ku përfshihet edhe vlera e TVSH). Në këtë kontekst nëse ka pasur gabime aritmetike me rastin e kalkulimit të çmimit përfundimtar të cilat nuk tejkalojnë +/- 2% të shumës përkatëse, atëherë këto gabime aritmetike lejohet që të përmissohen edhe nga vet autoriteti kontraktues në kuptim të nenit 40.9 të RRPP. Ky fakt nuk është kontestues me palëve (shih pikën 15 të ankesës së operatorit ekonomik). Në anën tjetër argumentimi i ekspertit shqyrtues është i bazuar në LPP dhe në dokumentet që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me këtë pretendim i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i tretë (III) i Operatorit Ekonomik Ankues është pretendim i bazuar në tërësi.**

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizimi me inventar për QPS-Prishtinë” me numër të prokurimit 616-23-1336-1-2-1 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vjosa GRADINAJ

Kryetare e Panelit Shqyrtues

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.